



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Përmet, më 27.12.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik LIQENI VII shpk me NIPT K01730502W Adresa: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozet, Durrës.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur - Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-87744-11-15-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga lidhja e kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë 14 (katërbëdhjetë) ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1.** Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ASI INVEST shpk me NIPT M01927023H dhe AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 42 003 557 (dyzetë e dy milion e tre mijë e pesëqind pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- 2.** ASI-2A CO shpk K53002402C  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 44 409 965 (dyzetë e katër milion e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- 3.** AVDULI shpk J667033060  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 47 055 060 (dyzetë e shtatë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 4. B-93 shpk** J62903508R  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 47 272 464 (dyzetë e shtatë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
- 5. BEQIRI shpk** J98624801V  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 42 000 000 (dyzetë e dy milionë) lekë pa TVSH.
- 6. C O L O M B O shpk** J82916489E  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 46 104 698 (dyzetë e gjashtë milion e njëqind e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
- 7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik COGREN shpk me NIPT J74818825K dhe TEA-D shpk me NIPT K32522629L**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 45 555 555 (dyzetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- 8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik EC Pro Partners shpk me NIPT J67902012U dhe EUROSTIL shpk me NIPT J99016203O dhe V E K O shpk me NIPT K12511628P**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 44 548 297 (dyzetë e katër milion e pesëqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- 9. Eduart Çela person fizik** M03806202I  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Pa vlerë të ofertës.
- 10. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik HASTA ENGINEERING shpk me NIPT M11511002J dhe O.B.KONSTRUKSION shpk me NIPT K93728201A dhe ABG Ndertim shpk me NIPT K03816401O**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 46 468 235 (dyzetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- 11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik HITO 94 shpk me NIPT J69102206O dhe ZEQILLARI shpk me NIPT L61912024O**  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 49 645 402 (dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e pesë mijë e katërqind e dy) lekë pa TVSH.
- 12. INA shpk** J61814009W  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 40 150 901 (dyzetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e një) lekë pa TVSH.

**13. LIQENI VII shpk** K01730502W  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 39 991 152 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**14. PEPA GROUP GROUP shpk** L42215009L  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t  
Vlera 47 885 999,20 (dyzetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje njëzetë) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:*

**1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ASI INVEST shpk me NIPT M01927023H dhe AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Ka gabime në vlerën e ofruar pa TVSH.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022) OE ASI INVEST shpk pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.
- Mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 të vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga OE ASI INVEST shpk pjesë e BOE-së si (matrapik;vibrator;zmerilatrice; Saldatrice/Motosaldatrice;Çekiç pneumatic hidraulik) janë pa nr.fature dhe datë. OE Agri Construction ka deklaruar kamion me targa TR8514G me kapacitet 3.54 ton dhe jo kamioncinë sic është kërkuar në DST.

**2. Operatori Ekonomik ASI-2A CO shpk me NIPT K53002402C**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Në preventivin ofertues të paraqitur në SPE nga OE ka mospërputhje me preventivin e AK pasi zëri A-1.1 ka nr. analize 2.426/1 dhe nga OE është paraqitur me nr.2.426 që sipas manualit të ndërtimit i përket zërit (Prishje mur tulle pa pastrim); Në zërin nr.C-1.16 është shënuar nr. analize 240.000 kur nga AK është kërkuar me nr. analize 480/2; zëri D-1.21 i paraqitur nga OE ka nr. e analizës An.V.1.14 kur nga AK është kërkuar nr. analize An.V.3.36; Zëri D-1.22 i paraqitur nga OE ka nr. analize An.V.1.15 kur nga AK është kërkuar me nr. analize An.V.3.37.
- Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve në këtë objekt që duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.
- Ky OE nuk ka ngarkuar në SPE deklaratën që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkuara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate.

**3. Operatori Ekonomik B-93 shpk me NIPT J62903508R**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- OE nuk ka paraqitur preventivin e ofertës sipas shtojcës 2 Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit.
- OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.2 bilanci i vitit 2022 është i pa konfirmuar nga Autoritetet përkatëse dega e Tatim-Taksave.

- OE nuk ka paraqitur në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 për përmbushjen e pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.6/1, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.10 të DST-ve.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur ky OE është një kontratë e realizuar si BOE ku sipas formularit të vlerësimit ky OE mbulon 66.84% të punimeve pra 21 757 417 lekë pa TVSH pra me pak se vlera që kërkohet nga AK në pikën 2.3.1/a të DST-ve si dhe mungon në SPE dokumentacioni në përputhje me pikën 2.3.1(pika 1.3)
- Nuk ka paraqitur në SPE grafikun e punimeve të kërkuar në pikën 2.3.11.

#### **4. Operatori Ekonomik C O L O M B O shpk me NIPT J82916489E**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Ka gabime aritmetike në ofertë midis vlerës pa TVSH të preventivit dhe asaj të ofruar në Shtojcën 1 formulari i ofertës në vlerën 1 374 667 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.
- Mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 të vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga OE C O L O M B O shpk 1(një) Saldatrice/Motosaldatrice nga 3(tre) copë të kërkuara nga AK.

#### **5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik COGREN shpk me NIPT J74818825K dhe TEA-D shpk me NIPT K32522629L**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Ka mospërputhje në vlerën me TVSH midis shtojcës nr. 1 Formular Oferte me shtojcën nr.2 Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit. Në lidhje me këtë pikë duke parë formularin e ofertës (shtojca 1) dhe listën e çmimeve sipas zërave të preventivit (shtojca 2) të paraqitur nga BOE në SPE ky BOE nuk i është referuar preventivit të hartuar nga AK. Gjatë llogaritjes së preventivit zëri **PAJISJET** është pa TVSH. Në shtojcën nr.1 ky OE vlerës totale pa TVSH i ka shtuar përsëri TVSH.
- Marrëveshjes së bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja që marrin përsipër OE nuk i është bashkëlidhur preventivi me ndarjen e përqindjes së punimeve për secilin OE pjesë e BOE-së.
- OE COGREN shpk pjesë e BOE-së nuk ka paraqitur në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.
- Bilanci i vitit 2020 i COGREN shpk nuk ka akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.
- Nuk janë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit pajisjet si: Çekiç pneumatik hidraulik copë 1; Fadromë me goma copë 1; Zmerilatriçe copë 2; Matrapik copë 2; Skeleri min 500 m2; fikëse zjarri, komplet ndihma e shpejtë dhe tabela paralajmeruese; Saldatriçe/Motosaldatriçe të deklaruar nga Tea-D janë pa sasi; Vibrator deklaruar nga Tea-D është pa sasi; Depozitë uji deklaruar nga TEA-D është pa sasi; Kokore pa sasi.
- OE pjesë e BOE-së nuk kanë ngarkuar në SPE deklaratën (nga Administratori i shoqërisë) për Drejtuesin Teknik të punimeve në këtë objekt që duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.
- Mungon në SPE deklaratat për mjetet që janë të pa angazhuara në kontrata të tjera.

**6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik EC Pro Partners shpk me NIPT J67902012U dhe EUROSTIL shpk me NIPT J99016203O dhe V E K O shpk me NIPT K12511628P**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022) OE EUROSTIL shpk pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.
- Bilanci i vitit 2022 të EC Pro Partners shpk nuk ka akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.
- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur OE V E K O shpk pjesë e BOE-së është kontrata me objekt “Rehabilitim i Sallës Farie Hoti dhe ambjenteve të shërbimit të Klubit Sportiv Tirana” e realizuar si BOE ku sipas formularit të vlerësimit ky OE mbulon 43.86% të punimeve por në SPE mungon kontrata e bashkëpunimit e lidhur tek noteri dokumentacion i kërkuar në përputhje me pikën 2.3.1(pika 1.3)
- Çertifikatat ISO të kërkuara në pikën 2.3.9 të OE V E K O shpk pjesë e BOE-së nuk kanë në fushën e tyre të çertifikimit objektin e prokurimit edhe pse ky OE bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ka marr përsipër punime ndërtimore.
- OE EUROSTIL shpk nuk ka kategoritë e liçensave NS-12 dhe NS-14 edhe pse në ndarjen e % së punimeve në preventiv ka marr përsipër punime që i mbulojnë këto lloje liçensash.

**7. Operatori Ekonomik Eduart Çela person fizik me NIPT M03806202I**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Ky OE nuk plotëson asnjë prej kërkesave për kualifikim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e tyre dhe as ofertë ekonomike dhe rrjedhimisht **SKUALIFIKOHET** nga procedura objekt prokurimi.

**8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik HASTA ENGINEERING shpk me NIPT M11511002J dhe O.B.KONSTRUKSION shpk me NIPT K93728201A dhe ABG Ndertim shpk me NIPT K03816401O**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.2.1 për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022) OE HASTA ENGINEERING shpk pjesë e BOE-së e ka më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.
- Bilanci i vitit 2021 i ABG Ndertim shpk nuk ka akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar edhe pse është në kushtet e nenit 41 gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009.
- Punët e ngjashme të paraqitura nga OE HASTA ENGINEERING shpk referuar % që ky OE ka marr përsipër në punët e ngjashme që ka realizuar për përmbushjen e pikës 2.3.1/b nuk janë në vlerën e kërkuar prej 4 414 750 lekë pa TVSH sipas përqindjes prej 3.96% si dhe ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar ku tek objekti: “Riparim pjesor i catise se godines se administrates dhe lyerje e ambjenteve te zyrave brenda godines ne Qendren Spitalore te Burgjeve Tirane” mungon akti i kolaudimit.
- Në preventivin ofertues të paraqitur në SPE nga BOE ka mospërputhje me preventivin e AK pasi zëri C-1.26 ka nr.analize 2.a-93 dhe nga BOE është paraqitur me nr.2.a-96; zëri nr.D-1.13 është shënuar nr. analize 240.000 kur nga AK është kërkuar me nr. analize

480/2; zëri D-1.21 i paraqitur nga BOE ka nr. e analizës 2.535/e kur nga AK është kërkuar nr.analize 2.535/g; Zëri E-7 i paraqitur nga BOE ka ndryshime në specifika ku kapaciteti në ftohje/ngrohje është shënuar 2.2/3.2kW nga 2.2/2.4 kW që është kërkuar nga AK si dhe nga BOE është shënuar vaj.nom =510 m' ndërsa nga AK është kërkuar me specifikimin vaj.nom=450 m'. Në zërat e preventivit me nr. E-20 dhe E-21 BOE nuk ka shënuar karakteristikat teknike të kërkuara nga AK.

## **9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik HITO 94 shpk me NIPT J69102206O dhe ZEQILLARI shpk me NIPT L61912024O**

Konkretisht për arsyet e mëposhtme:

- Në lidhje me përmbushjen e pikës 2.3.1/a puna e ngjashme që ka paraqitur OE ZEQILLARI shpk pjesë e BOE-së është kontrata me objekt “Ndërtimi i një Kompleksi Agroturistik me ambiente argëtuese dhe çlodhëse” ku nuk ka paraqitur në SPE çertifikatën e marrjes në dorëzim në përputhje me pikën 2.3.1 (1.2/b).
- Disa nga mjetet/pajisjet/makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate të përcaktuara në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.10 janë vetëdeklaruar në shtojcën 8 nga të dy OE pjesë e BOE-së pa sasi, nr.fature dhe datë. OE HITO 94 shpk ka deklaruar kamionçinë me targa AA831SA por pa përcaktuar kapacitetin sic është kërkuar në DST. Nga 2 (dy) Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton të kërkuar është deklaruar vetëm 1(një) sipas kërkesave në DST me targa AA459DU.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorët ekonomik, të cilët në rastin konkret kanë dështuar ta vërtetojnë atë.

Një nga parimet kryesore ku mbështetet veprimtaria e zyrtarëve publikë, sic janë zyrtarët e prokurimit është parimi i ligjshmërisë i sanksionuar në Kodin e Procedurës Administrative si dhe në Ligjin e prokurimeve. Ky parim, do të thotë që zbatimi i një norme të caktuar apo një kriteri për kualifikim në rastin konkret duhet të bëhet në harmoni me bazën tjetër ligjore të aplikueshme në fuqi.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, *vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

Nga shqyrtimi i këtyre ofertave në SPE si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatorët ekonomik të mësipërm ***nuk kanë paraqitur dokumentacion*** të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke ***I SKUALIFIKUAR si oferta.***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik LIQENI VII shpk me NIPT K01730502W me adresë Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 39 991 152 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**Alma HOXHA**